

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3179 .Prot.

Rrogozhinë, më 08.08.2026

PROJEKT - VENDIM
Nr. .datë 08.2026


**PËR KUNDËRSHTIMIN E DRAFTIT TË RI TË ORGANIZIMIT ADMINISTRATIVO-
TERRITORIAL QË PARASHIKON SHKRIRJEN E BASHKISË RROGOZHINË**

Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, mbështetur në nenet 108 dhe 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, si dhe në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, Pasi u njoh me draftin e organizimit të ri administrativo-territorial të propozuar nga deputetët e mazhorancës në parlament, i cili parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë dhe bashkimin e saj me një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore; Duke vlerësuar se:

Vetëqeverisja vendore është një parim themelor kushtetues që garanton përfaqësimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe administrimin e interesave të komunitetit lokal. Bashkia Rrogozhinë përfaqëson një territor me identitet të konsoliduar historik, administrativ, ekonomik dhe shoqëror, i cili ka zhvilluar ndër vite institucionet dhe kapacitetet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Shkrirja e Bashkisë Rrogozhinë do të sillte largimin e vendimmarrjes nga qytetarët, uljen e aksesit në shërbimet publike, dobësimin e përfaqësimit vendor dhe rrezikun e marginalizimit të interesave të komunitetit. Çdo reformë administrativo-territoriale duhet të mbështetet në analiza objektive, kritere të matshme, konsultim të gjerë publik dhe transparencë të plotë me komunitetet e prekura. Deri më sot nuk janë paraqitur argumente bindëse që provojnë se shkrirja e Bashkisë Rrogozhinë do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, eficiencën administrative apo zhvillimin ekonomik të territorit. Nisur nga këto arsye dhe jo vetëm Këshilli Bashkiak Rrogozhinë unanimisht, propozon,

TË VENDOSË:

1. Këshilli Bashkiak Rrogozhinë shpreh kundërshtimin e plotë ndaj draftit të ri të organizimit administrativo-territorial, të propozuar nga deputetët e mazhorancës në parlament pjesë e komisionit të posaçëm parlamentar për reformën administrative - territoriale që parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë.
2. Këshilli Bashkiak kërkon ruajtjen e statusit të Bashkisë Rrogozhinë si njësi e pavarur e vetëqeverisjes vendore, duke vlerësuar se ajo plotëson funksionet, përgjegjësitë dhe misionin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

3. Këshilli Bashkiak i kërkon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, Ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor dhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale që të rishikojnë draftin, duke marrë në konsideratë argumentet institucionale, ekonomike, sociale dhe historike të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Këshilli Bashkiak kërkon që, përpara çdo vendimmarrjeje përfundimtare mbi organizimin administrativo-territorial, të zhvillohet një proces i plotë konsultimi publik me qytetarët, institucionet vendore, grupet e interesit dhe subjektet e tjera të prekura.
5. Ngarkohet Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë për dërgimin e këtij vendimi pranë institucioneve qendrore përkatëse dhe për ndërmarrjen e çdo veprimi institucional në mbrojtje të integritetit administrativ të Bashkisë Rrogozhinë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

SHPATI KOLGEGA

RENATO KALEMI

FATMIRI THARTORI

HEKURAN XHANI

SILVANA ALIU

INDRIT DEDEJ

ERIND TOSKU

SOKOL GOSA

ALTIN TOSKU

LORENA BAKU

LULZIM HASA

GEZIME MET-HASANI

ALIME HOXHA

BESNIKE CORAJ

ENVER MEMOLLA


DHURATA MEKA

KRYETARË E KËSHILLIT

MUKADES GIXHARI



Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. **3179/** .Prot.

Rrogozhinë, më **08.08.2026**

RELACION
PËR PROJEKT-VENDIMIN "PËR KUNDËRSHTIMIN E DRAFTIT TË RI TË
ORGANIZIMIT ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL QË PARASHIKON SHKRIRJEN
E BASHKISË RROGOZHINË"

I. Qëllimi i projekt-vendimit

Ky projekt-vendim ka për qëllim shprehjen e qëndrimit institucional të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë kundër draftit të ri të organizimit administrativo-territorial, i cili parashikon shkrirjen e Bashkisë Rrogozhinë dhe bashkimin e saj me një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore.

Qëndrimi i Këshillit Bashkiak mbështetet në parimet kushtetuese të autonomisë vendore, në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, si dhe në nevojën për të garantuar një administrim sa më pranë qytetarëve, duke ruajtur identitetin, funksionalitetin dhe potencialin zhvillimor të Bashkisë Rrogozhinë.


II. Argumentimi i projekt-vendimit

Bashkia Rrogozhinë përfaqëson një njësi vendore me identitet të konsoliduar historik, administrativ, ekonomik, kulturor dhe shoqëror. Ajo nuk është vetëm një ndarje administrative, por një territor me karakteristika të veçanta zhvillimore dhe me kapacitete të provuara për të ushtruar funksionet e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore.

Sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, Bashkia Rrogozhinë përbëhet nga një komunitet prej rreth **43.000 banorësh**, organizohet në **5 njësi administrative** dhe përfshin **36 fshatra**, duke garantuar një administrim të afërt me qytetarët dhe një përfaqësim të drejtë të komuniteteve që e përbëjnë.

Që nga reforma administrativo-territoriale e vitit 2015, Bashkia Rrogozhinë ka dëshmuar se ka kapacitetet administrative dhe institucionale për të përmbushur me sukses funksionet e saj ligjore. Përkundrazi, kjo periudhë ka shërbyer për konsolidimin e institucioneve vendore, rritjen e investimeve publike dhe shfrytëzimin më të mirë të potencialeve ekonomike dhe turistike të territorit.

Një nga asetet më të rëndësishme të bashkisë është potenciali i saj turistik. Bashkia administron vijën bregdetare të **Plazhit të Spillesë** dhe **Vilë-Bashtovës**, të cilat përbëjnë ndër destinacionet më të frekuentuara të turizmit bregdetar në Shqipërinë e Mesme. Pas vitit 2015 janë realizuar investime të rëndësishme në rivitalizimin e kësaj vije bregdetare, duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën, aksesin, hapësirat publike dhe shërbimet për pushuesit. Këto investime kanë



rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve dhe kanë krijuar mundësi të reja për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe biznesit turistik.

Rrogozhina disponon gjithashtu një nga zonat bujqësore më produktive të vendit. Tokat pjellore, tradita shumëvjeçare në bujqësi dhe blegtori, si dhe aktiviteti intensiv i fermerëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë vendore. Një dëshmi e potencialit rural është edhe përzgjedhja e fshatit **Gërmenj** në Programin Kombëtar "**100 Fshatrat**", program i cili synon zhvillimin e zonave rurale me potencial të lartë ekonomik, turistik dhe kulturor.

Bashkia Rrogozhinë ka ndërtuar ndër vite një identitet të spikatur edhe në kulturë dhe sport. Veçanërisht në sport, ajo ka shërbyer si model i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe investitorëve privatë. Në vitin 2020, Këshilli Bashkiak vendosi bashkëthemelimin e shoqërisë aksionare "**Futboll Klub Egnatia**", një vendim që hapi rrugën për investime serioze në infrastrukturën sportive.


Falë këtij vizioni u ndërtua **Arena Egnatia**, një stadium modern që plotëson standardet ndërkombëtare dhe ku janë zhvilluar ndeshje të kompeticioneve evropiane. **Futboll Klub Egnatia**, është shpallur **kampion i Shqipërisë për tre sezone radhazi**, fitues i **dy Kupave të Shqipërisë**, fitues i **Kategorisë së Parë në sezonin 2021–2022**, ndërsa aktualisht vazhdon të përfaqësojë me dinjitet futbollin shqiptar në garat evropiane. Këto arritje dëshmojnë se Bashkia Rrogozhinë ka ditur të krijojë klimën e duhur për të tërhequr investime, për të zhvilluar sportin dhe për ta kthyer atë në një faktor promovues të territorit.

Përveç këtyre elementeve, Bashkia Rrogozhinë gëzon një pozicion të favorshëm gjeografik, potencial të konsiderueshëm ekonomik, lidhje të rëndësishme infrastrukturore dhe burime njerëzore që i japin mundësi reale për zhvillim të qëndrueshëm.

Në këto kushte, nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë analizë objektive që të provojë se shkrimja e Bashkisë Rrogozhinë do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike, do të rrisë eficiencën administrative apo do të krijojë përfitime më të mëdha për qytetarët. Përkundrazi, një masë e tillë do të rrezikonte dobësimin e përfaqësimit vendor, largimin e vendimmarrjes nga komuniteti dhe zbehjen e identitetit institucional të një bashkie që ka dëshmuar aftësi të plota për të përmbushur misionin e saj.

Çdo reformë administrativo-territoriale duhet të mbështetet në kritere të qarta, analiza të mirëfillta ekonomike e sociale, konsultim të gjerë me komunitetin dhe respektim të parimeve të autonomisë vendore, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

Për të gjitha arsyet e mësipërme dhe jo vetëm, vlerësohet se Bashkia Rrogozhinë i plotëson të gjitha kriteret për të vijuar funksionimin si njësi e pavarur e vetëqeverisjes vendore. Ajo ka një popullsi të konsiderueshme, territor të mirëorganizuar administrativisht, potencial të madh ekonomik, bujqësor dhe turistik, identitet të spikatur kulturor e sportiv, si dhe institucione të konsoliduara që kanë dëshmuar aftësi në administrimin e interesit publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Ruajtja e Bashkisë Rrogozhinë si njësi më vete nuk përfaqëson vetëm mbrojtjen e një ndarjeje administrative, por garantimin e vazhdimësisë së zhvillimit ekonomik e social të territorit, të përfaqësimit demokratik të qytetarëve dhe të identitetit të një komuniteti me histori, traditë dhe perspektivë të qartë zhvillimi.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i projekt-vendimit, "Për kundërshtimin e draftit të ri të organizimit administrativo-territorial që parashikon shkrijen e Bashkisë Rrogozhinë".

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI



Adresa: Lagja Nr.1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori", e-mail: bashkia.rrogozhine@bashkiarrogozhine.gov.al